

VENDIM
Nr. 71, datë 27.5.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË KESH
SHA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 1 KORRIK 2016–31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 18; 20 dhe 21, të “Rregullave të praktikës

dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe e Tarifave,

konstatoi se:

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti